

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Diskutimet për pagat e magjistratëve/ Manja: Hiqen shtesat deri në 80%, koeficienti rritet nga 0.36% në 0.38%. Askush nuk mund t'i marrë Kuvendit kompetencat
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/17/diskutimet-per-pagat-e-magjistrateve-manja-hiqen-shtesat-deri-ne-80-koeficienti-rritet-nga-0-36-ne-0-38-askush-nuk-mund-ti-marre-kuvendit-kompetencat/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 21:11:54 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	17 shtator 2026, 20:42:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 17 shtator 2026, 20:41:00 UTC → 17 shtator 2026, 20:43:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t'ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	77aba7f52240a7b7c5ea336846fa7655052b7679897959eaf1c36278cdeb10de
TEKSTI	d472f848606851f99b4b27a5dde6083aa1a2b06c1aca14523afdf598768335ba
PAMJA	8455031006c1c83f77326910d7fc12ae2988ca372f1559d6cf81296cfc13be8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2a98f4f990fef57a02ed9e87c1fc81f01402482dcc4736f6560a24b5fa501522
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	2ab42df455d4ef8aa fed34b1999da6330f86b7fbd52ac9b377015a4a4fca590c
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2a98f4f990fef57a02ed9e87c1fc81f01402482dcc4736f6560a24b5fa501522>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KRYESORE POLITIKË TË FUNDIT

Diskutimet për pagat e magjistratëve/ Manja: Hiqen shtesat deri në 80%, koeficienti rritet nga 0.36% në 0.38%. Askush nuk mund t'i marrë Kuvendit kompetencat

17/09/2026 22:42



Ulsi Manja deklaroi mbrëmjen e sotme në Kuvend se varianti përfundimtar i ndryshimeve për pagat e magjistratëve është i ndryshëm nga nisma fillestare, pasi janë hequr shtesat e propozuara për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë dhe Prokurorin e Përgjithshëm.

Gjatë fjalës së tij në seancën plenare, kryetari i Komisionit të Ligjeve tha se projektligji që i është paraqitur Kuvendit për votim synon të adresojë vendimin nr. 15 të vitit 2026 të Gjykatës Kushtetuese, konkretisht formulën e pagës referuese të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe efektet financiare që rrjedhin prej saj.

Sipas Manjës, vendimi i Kushtetueses nuk ka kërkuar që të miratohen disa prej përfitimeve që ishin përfshirë në variantin fillestar të nismës.

"Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nuk ka thënë të adresohet shtesa për vështirësi pune në masën 80% të pagës bruto fillestare për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë dhe Prokurorin e Përgjithshëm, as shtesa për funksion 5% të pagës bruto fillestare për Prokurorin e Përgjithshëm dhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, as shtesa për vështirësi në masën 2% të pagës referuese për çdo vit përvojë pune", deklaroi Manja.

Ai theksoi se varianti i miratuar në Komisionin e Ligjeve dhe që kaloi për votim në seancë adreson pagën referuese të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke e lidhur atë me pagën e Presidentit të Republikës, si dhe efektet financiare të ndryshimit nga 1 prilli 2023 deri në hyrjen në fuqi të ligjit.

Manja iu përgjigj edhe akuzave për mënyrën se si u ndryshua nisma fillestare. Sipas tij, amendamentet që hoqën shtesat e parashikuara për Gjykatën e Lartë dhe Prokurorin e Përgjithshëm janë depozituar me shkrim nga deputeti Ermal Paçaj dhe janë votuar në Komisionin e Ligjeve në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

"S'ka asnjë shkelje të Kushtetutës dhe të Rregullores së Kuvendit dhe s'ka tre drafte, hiq një, fut një, siç u tha këtu", deklaroi ai.

Kreu i Komisionit të Ligjeve u ndal edhe te debati se kush e kishte kompetencën për të vepruar pasi Kuvendi nuk e adresoi vendimin e Gjykatës Kushtetuese brenda afatit të 31 korrikut 2026.

Manja tha se përfundimi i këtij afati nuk ia heq Kuvendit kompetencën për të përcaktuar me ligj formulën e pagave. Ai iu referua paragrafit 109 të vendimit të Kushtetueses, duke argumentuar se Kuvendi ruan kompetencën dhe diskreionin për formulën e re të pagave të magjistratëve.

"Gjeni një paragraf ku thuhet që pas 31 korrikut 2026 kompetencat e ligjvënësit pozitiv i merr një pushtet tjetër, i merr KLGJ-ja, KLP-ja apo i merr gjykata me vendime. S'e thotë",

I Kryesore



Dënimi me 81 vite i ish-liderëve të UÇK-së, Grenell në Top Story: Kosova s'ka nevojë që vendimet t'i marrë një gjykatë në Holandë, duhet të vendosë vetë

21:52

Ekskluzive/ Poezi imagjinare me nënën, si Jakup Krasniqi i jepte vetes zemër në paraburgim

11:39

Alarmoi policinë për bombë në shkollën "Emin Duraku", "detyrim paraqitje" për Mandi Jataganin: Do ta bëj sërish nëse...

14:16

SHBA rit normat e interesit/ Rezerva Federale sfidon presionin e Trump: Inflacioni mbetet shumë i lartë

12:58

Kombëtarja shqiptare nis rrugëtimin e Nations League, të shtunën Maran publikon listën e të përzgjedhurve

12:35

I Më të lexuarat

E rëndë në Tiranë/ 12-vjeçarja abuzohet seksualisht nga tezja dhe djali i hallës, në telefonin e të miturës u zbuluan video intime dhe...

Pas vendimit të Hagës për ish-krerët e UÇK-së, Richard Grenell publikon foton e Bleona Qeretit me bluzën kuqezi

Kryeministri Rama viziton Malin Athos në Greqi, qëndron gjatë natës në Manastirin e Vatopedisë

Alarm në Gjermani, "plas" malaria e aeroportit, 8 të prekur e dy viktima në Frankfurt

Regjistruan 1143 hektarë me dokumente të falsifikuara/ Arrestohen dy ish-drejtorë dhe juristi i ASHK Fier, në pranga edhe përfituesi

Daja i deputetes së PS e rrahu dhe i plagosi me drapër të atin, 34-vjeçarja sqaron foton e publikuar nga Zëgjine Çaushtit: Ja si qëndron e vërteta

Deputetët në seancë plenare. Përkallëzon tubimi jashtë Kuvendit, protestuesit godasin me vezë dhe bllokojnë rrugën. Shoqërohet Dritan Goxhaj dhe disa të tjerë

"Gjyshi i saj një vrasës serial, i ka marrë jetën shumë njerëzve të pafajshëm"/ Akuzat

deklaroi Manja.

Sipas tij, asnjë institucion tjetër nuk mund të marrë atributet e ligjvënësit, ndërsa çdo efekt mbi Buxhetin e Shtetit kërkon autorizim ligjor nga Kuvendi.

"Me votën sot ne adresojmë tri problematika: pagën referuese të Presidenti, që nuk e ndryshojmë, por ndryshojmë koeficientin nga 0.36 në 0.38, me efekte financiare nga 1 prilli 2023 dhe ligji hyn në fuqi menjëherë", tha ai.

Manja parashikoi gjithashtu se çështja mund të përfundojë sërish në Gjykatën Kushtetuese, por tha se debati për pagat në drejtësi nuk mbyllet me këtë projektligj.

Sipas tij, në kuadër të një analize 10-vjeçare të reformës në drejtësi duhet të rishikohet e gjithë "piramida" e pagave në sistem.

"Do të jem për një arkitekturë piramidale të pagave të drejtësisë, me bazë gjykatat e shkallës së parë, Apelin dhe Gjykatën e Lartë, duke përfshirë SPAK-un për ato arsye që janë të shkruara në ligj", deklaroi Manja.

Ai shtoi se diferenca mes pagave të gjyqtarëve të shkallës së parë dhe atyre të Gjykatës së Lartë duhet të mbahet brenda disa kufijve, duke marrë në konsideratë standardet e vendeve të rajonit dhe ato europiane.

"Pasi ta votojmë këtë ligj sonte, që të plotësojmë një boshllëk ligjor, bujrum qeveri, Kuvend, sistem, të ulemi! Pse jo, të kërkojmë edhe ndihmën e partnerëve europianë që të shohim si janë standardet", përfundoi Manja.

Top Channel

I Kryesore »



Deputetja e PDK tregon në Top Story prapaskenat e largimit të spiunëve nga Kosova, Musliu: Në 2015-ën u mbushën autobusët, gënjyen edhe për...

17/09 22:55



Spektakël në Torino, Juventus shënon 5 gola dhe e nis Europën me këmbën e mbarë

17/09 22:54



Vendimi i Hagës ngre peshë Prishtinën, protestë me thirrje "UÇK", Time Kadriaj për Top Story: Do votoj për zhbërjen e 'Speciales'

17/09 22:46



Qeveria në Greqi premtan ulje të naftës së ngrohjes dhe rritje të ndihmës, Mitsotakis: Kërkoj stabilitet pas zgjedhjeve

17/09 22:45



"Vendimi nga Haga është pozitiv për Kosovën", deklarata e studiuesit Spahiu shkakton debat në Top Story, Rakiplari: Je gëzuar ti më shumë se Vuçiç

17/09 22:34



"Besojmë në pafajësinë e të gjithë çlirimtarëve tanë" / Djali i Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit krah njëri-tjetrit në protestën kundër vendimit për ish-krerët e UÇK-së

17/09 22:29

I Politikë »



Pagat e gjyqtarëve diskutim në Kuvend, Rama mbërrin në seancë, në pritje të votimit

17/09 21:48




"Ne në fshat jemi akoma me parmenda, ju thoni IA", Korreshi ironizon qeverinë: Qendrat shëndetësore s'kanë as poça, si do hyjë infermierja në sistem?

17/09 19:54



"U përdoqa nga një grup që më ngjanin me pionerët e Enverit", deputetja Luarasi flet për videon e sulmit verbal: 730 komente që flisnin për varje dhe pushkatim

17/09 19:27



e reja të SPAK për Ballukun, Berisna: Po tregon që është mbesa e Beqir Ballukut

Transportonte flori dhe para me "Porsche Cayenne", arrestohet 30-vjeçari në Roskovec. Sekuestrohet "Bently" me vlerë 250 mijë euro

Hashim Thaçi reagon për herë të parë pas dënimit me 25 vite burg nga Gjykata në Hagë: Mohoj çdo përfshirje në vrasje, do ta apeloj vendimin



Kryeministri Rama viziton Malin Athos në Greqi, qëndron gjatë natës në Manastirin e Vatopedisë

17/09 19:16



Përplasja për pagat e gjyqtarëve, reagon Shoqata Evropiane e Magjistratëve: Po cenohet shteti i së drejtës, të mos anashkalohej vendimi i Kushtetueses

17/09 17:31



Dënimi i Hagës/ Protesta edhe në SHBA, prefekti Shkëlqim Hajdari nga Times Square: Liri për çlirimtarët!

17/09 16:29

Na ndiqni:



I Video »



Top News- Rusia godet anijen turke pranë kufirit me Rumaninë, Ankara ja e NATO gati për "luftë"



Top Channel/Pagat e gjyqtarëve/Gjoni: Baballarët e reformës caktuan një rregull që sot se zbatoni dot



Top Channel/Pagat e Gjyqtarëve/ Bardeli: Vendimi i Kushtetueses pa veprim, dëmton shtetin



Lajmet kryesore të ditës – Top News, 17 Shtator 2026



Top Channel/ Baballarët në burg, djali i Thaçit dhe Veselit krah njëri-tjetrit: Do të mbështesim...



Top Channel/ Pagat e gjyqtarëve/ Manja Opozitës: Të mos ju digjet shpirti për këtë projektligj, ju...

Lajme

Lajmet e fundit
Politikë
Kronikë
Aktualitet
Ekonomi
Sociale
Video
Top News LIVE

Bota

Opinion
Koment
Kosova dhe Rajoni
Shkencë dhe Teknologji
Auto

Sport

Kombëtarja
Kategoria Superiore
Kategoria e Parë
Premier League
La Liga
Serie A
Shumësportësh
Sport Gossip

Pop News

Showbiz
Lifestyle
Fashion
Shëndeti
Dieta
Receta gatimi

Programe

Big Brother VIP
Për'puthen
Shqipëria LIVE
Fiks Fare
Video
Të gjitha programet
Guida TV

Top Channel

Rreth Top Channel
Topin e kam unë – Apliko tani!
Kontakt
Puno në Top Channel
Privacy Policy & Terms of Use
Aksesueshmëria

© Top Channel 2001 - 2026 - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.